

## Shoqata **Frauen helfen Frauen e. V.**

i drejton 2 institucione: **Zyrën për këshillimin e grave dhe/ Shtëpinë e grave.**



### Zyra për këshillimin e grave

Ne jemi person kontaktues për secilën grua dhe secilën vajzë (nga moshë 14 vjeçare). Tek ne mund të vini me të gjitha hallet tuaja. Ne ju informojmë, ju këshillojmë dhe ju përkrahim në të gjitha situatat jetësore. Ne ju këshillojmë përmes telefonit dhe personalisht, varësisht nga nevoja, një herë apo në një sërë këshillimesh. Edhe përcjellja afatgjate psiko-sociale dhe terapeutike është e mundshme. Ju mund ta caktoni një termin përmes telefonit ose të vini në kohën e hapur për këshillime të enjteve prej orës 14:00 deri në orën 16:00. Na u drejtoni në raste të:

- Përjetimit të dhunës dhe të kërcënimit
- Abuzimit seksual
- Konflikteve në partneritet apo në familje
- Ndarjes dhe divorcimit
- Krizave psikike
- Frikës dhe dëshpërimit
- Konflikteve në vend të punës
- Problemeve me varësi, edhe tek anëtarët e familjes
- Ndërmjetësimit në një shtëpi të grave
- Për të gjitha çështjet tjera, dëshirat për informim dhe problemet.

**0 27 61 . 17 22**

**Ne i nënshtrohemi detyrimit të heshtjes dhe këshillimi është pa pagesë.**

### Kontakti

Frauenberatungsstelle · Friedrichstraße 24 · 57462 Olpe

Telefon 0 27 61 . 17 22 · Faksi 0 27 61.34 27

frauenberatungsstelle-olpe@gmx.de · www.frauenhelfenfrauen-olpe.de



Shoqata **Frauen helfen Frauen e. V.**

i drejton 2 institucione: **Zyrën për këshillimin e grave dhe/ Shtëpinë e grave.**



## Shtëpinë e grave

Ne jemi e vetmja shtëpi mbrojtëse në qarkun Olpe. Ne i forcojmë gratë për një jetë, për të cilën vendosin vetë ato, dhe një jetë pa dhunë. Ne ofrojmë pranim 24-orësh dhe joburokratik të grave që janë të prekura nga dhuna. Ne informojmë, i këshillojmë dhe i përkrahim gratë në situata të ndryshme jetësore.

### Intervenime krize në situata akute të emergjës në raste të

- Përvojës së dhunës, Kërcënimit, Përndjekjes
- Abuzimit seksual, Stalking-ut

### Ne ndihmojmë përmes

- Mbrojtjes përmes adresës anonime
- Pranim pavarësisht prej statusit të qëndrimit dhe të ardhurave
- Mundësisë së banimit në dhomë vetanake
- Përpunimit të dhunës së përjetuar
- Sigurimit të ekzistencës
- Këshillim dhe përcjellje në çështje të edukimit, çështje mjekësore dhe juridike
- Zhvillimin e perspektivave të reja jetësore

**0 27 61 . 83 46 84**

### Ne u ofrojmë fëmijëve

- Pranim pa kufizim të moshës
- Një mjedis pa frikë dhe pa dhunë
- Personin e veçantë kontaktues
- Oferta të rregullta për fëmijë në bazë javore
- Ndihmë në kryerjen e detyrave të shtëpisë
- Përkrahje me rastin e ndërrimit të çerdhes, gjegjësisht shkollës
- Përkrahje me rastin e kontakteve vizituese me babanë

## Kontakti

Frauenhaus Olpe · Postfach 13 25 · 57443 Olpe

Telefon 0 27 61 . 83 46 84 · Faksi 0 27 61 . 83 54 43

frauenhausolpe@gmx.de · www.frauenhelfenfrauen-olpe.de

